

**Akt Themelimi  
dhe  
STATUT**  
**i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BEDOUIN" sh.p.k.**

**Në Tiranë sot më datë 30.03.2022 mbahet ky Akt Themelimi dhe STATUT, në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, nga themeluesi i mëposhtëm:**


**Z. Flladi Agolli** i biri i Rovena dhe Dritan, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30.09.1997, lindur në Tiranë, banues në Bulevardi Zogu I, Rruga "Maliq Muço", Pall nr. 4, H. 6, Ap.44, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. J70930073N; madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar): këtu e në vijim referuar si "**Themeluesi**"


(A)	<b>Kushte paraprake:</b> Vendimi i miratuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë z.Flladi Agolli për <b>themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "BEDOUIN"</b> .
(B)	<b>Baza Ligjore:</b> ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar); ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" (i ndryshuar); ligji nr. 131/2015, datë 26.11.2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"; ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar).
<b>Nr.</b>	<b>Titulli &amp; Përbajtja</b>
<b>KREU I</b>	<b>THEMELIMI, FORMA, EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA</b>
<b>Neni 1</b>	<b>Forma dhe themeluesi</b>
1.1	Shoqëria "BEDOUIN" sh.p.k. është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), me ortak të vetëm themelues z. Flladi Agolli.
<b>Neni 2</b>	<b>Emërtimi</b>
2.1	Emërtimi i shoqërisë është " <b>BEDOUIN</b> " sh.p.k.
<b>Neni 3</b>	<b>Selia dhe ushtrimi i veprimtarisë</b>
3.1	Shoqëria e ka selinë në adresën: Rr. "Ibrahim Rugova", Kompleksi "Green Park", Kati VI, Ap.22, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, Shqipëri.
3.1	Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në adresën dytësore Kompleksi Vala Mar, Hamallaj, Durrës, Shqipëri.
3.3	Me Vendim të Ortakut të vetëm, Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë seli, të hapë adresën e tijerë të aktivitetit brenda territorit të Shqipërisë, zyra përfaqësie e degë të Shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të themelojë apo të jetë bashkëthemeluese në subjekte të reja juridike, apo të blejë kuota/aksione të subjekteve juridikë ekzistues.
<b>Neni 4</b>	<b>Objekti i veprimtarisë</b>
4.1	Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo lloj veprimtarie, e cila nuk ndalohet me ligj.
4.2	Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin veprimtaritë e mëposhtme, por nuk kufizohet në to, si: Hapjen dhe menaxhimin e bar-kafeve, fast-food dhe restoranteve, të vetë Shoqërisë apo të të tretëve apo (përfshirë ato të ndodhura brenda strukturave turistike pritëse/akomoduese, resorteve, komplekseve), dhe të gjitha shërbimet direkte apo indirekte të lidhura me to (përfshirë shërbimet e kateringut apo veprimtaritë fushën e gastronomisë), si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar; Krijimi dhe organizimi i festave apo eveneteve social-kulturore; Të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi; Administrim dhe manaxhim i sipërfaqeve/ ambjenteve publike dhe private ranore, plazhe dhe çdo shërbim i lidhur ngushtësisht me to (si pastrim, gjelbërim, ruajtje dhe mirëmbajtje), komplekse pushimi/argëtimi; Hapjen, operimin dhe menaxhimin e Stacioneve të Plazhit, lundrime turistike, sporte ujore dhe të tjera; Ngritjen dhe manaxhimin e pistave detare për aktivitetet e ndryshme; Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritisës, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse/akomoduese dhe të gjitha shërbimeve direkte apo indirekte të lidhura me to (përfshirë ofrimin e shërbimit të guidës turistike), si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar; Organizimi i udhëtimeve turistike (individuale apo kolektive) dhe shërbime transporti të lidhura me aktivitetin e shoqërisë, me mjete të të tretëve apo të vetë Shoqërisë; Shfrytëzimin e zonave malore/pyjore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, shërbimeve që lidhen me ushqimin dhe mikpritjen në zona turistike etj.; Shërbime mbështetëse; Shitblerje konfeksione mallrash dhe produkte specifike, përfshirë shitjet online; Tregti, import-eksport

Adresa e selisë: Rr. "Ibrahim Rugova", Kompleksi "Green Park", Kati VI, Ap.22, Njësia Administrative nr.5, Tiranë, Shqipëri




	mallrash dhe paisjesh, ushqimore dhe industriale, produkte bujqësore, blegtore, fruta perime, prodhime të detit, pijeve freskuese e alkoolike, të markave e llojeve të ndryshme; Transaksione të ndryshme që lidhet me asete, të pasurive të luajtshme/paluajtshme, përfshirë dhënie me qira apo përdorim, kryerje të veprimeve tregtare, industriale, të nevojshtme për arritjen e objektivave të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.
<b>Neni 5</b>	<b>Kohëzgjatja</b>
5.1	Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.
<b>KREU II</b>	<b>KAPITALI I SHOQËRISË (ZMADHIMI, ZVOGËLIMI, TRANSFERIMI)</b>
<b>Neni 6</b>	<b>Kapitali</b>
6.1	Kapitali themeltar filletar i shoqërisë është <b>100,000 (njëqind mijë) lekë</b> .
6.2	Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm themelues z. Flladi Agolli dhe është i ndarë në <b>1 (një) kuotë</b> me vlerë të përgjithshme totale <b>100,000 lekë</b> , që përbën <b>100%</b> të kapitalit themeltar të shoqërisë.
6.3	Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe do të shlyhet tërësisht në të holla nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë.
<b>Neni 7</b>	<b>Zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit</b>
7.1	Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet pa kufizim duke respektuar kërkuesat e detyrueshme ligjore, në çdo moment, një apo disa herë dhe vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm, nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë për kontributet e derdhura nga ortaku në para apo me anë të kontributeve në natyrë, sipas procedurave ligjore të parashikuara në këtë rast.
7.2	Zvogëlimi i kapitalit lejohet të realizohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm, në bazë të përcaktimeve në ligj dhe në statut.
7.3	Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar nga ligji i shoqërive tregtare, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën nominale.
<b>Neni 8</b>	<b>Transferimi i kuotave</b>
8.1	Vetëm me miratimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm, kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund t'u transferohen apo kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri (nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit, dhe çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj).
8.2	Pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë janë lirisht të transferueshme, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
<b>KREU III</b>	<b>ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE</b>
<b>Neni 9</b>	<b>Organi vendimmarrës</b>
9.1	Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, përgjegjës për marrjen e vendimeve për ato çështje që parashikon ligji për këtë organ.
9.2	Asambleja e Ortakut të Vetëm, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, brenda datës 30 Qershori të çdo viti, miraton Pasqyrat financiare, të hartuara nga administratori/ët apo ekspertë kontabël. Dokumentet e miratuara depozitohen prane autoriteteve përkatëse tatimore si dhe prane regjistrat tregtar sipas afateve ligjore.
9.3	Ortaku mund të përfaqësohet në asamble edhe nga një person tjetër, nëpërmjet një autorizimi. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakut në asamble.
<b>Neni 10</b>	<b>Ndryshimet në statut</b>
10.1	Çdo ndryshim në statut miratohet apo vendoset vetëm nga Asambleja e Ortakut të Vetëm.
10.2	Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë në regjistrin tregtar, duke aplikuar brenda 30 ditëve nga data e vendimit.
10.3	Shoqëria mban gjithmonë një Statut të azhurnuar, ku reflektohen të gjitha ndryshimet e miratuara.
<b>Neni 11</b>	<b>Administrimi</b>
11.1	Administrator i shoqërisë është z. Ervis Çepele, I biri i Kasem dhe Olimbi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 21.02.1985, lindur në Roskovec, Fier dhe banues në Rr. "Ndre Mjeda", kompleksi "Magnet", Hyrja 3, Ap. 2033, kat. III, Nj.B.7, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit nr.I50221026C; madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar), duke i deleguar atij të gjitha kompetencat e përcaktuara në Statutin e Shoqërisë, i cili emërohet në këtë detyrë për një periudhë kohore prej <b>2 (dy) vitesh</b> , që fillon nga momenti i



	regjistrimit në QKB dhe deri sa Asambleja e Ortakut të Vetëm të shoqërisë të vendosë shkarkimin e tij.	
11.2	Administratori i shoqërisë z. Ervis Çepele ka këtë specimen nënshkrimi:	
11.3	Në rast se gjatë veprimtarisë së shoqërisë do të vendoset ndryshe në lidhje me administrimin, detyrimisht Administratori i ri i shoqërisë do të emërohet dhe shkarkohet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.	
11.4	Asambleja e Ortakut të Vetëm vendos për sistemin e administrimit, përcakton numrin e administratorëve dhe kompetencat e tyre. Sipas ligjit, Administratori mund të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë maksimale 5 vjeçare, por është Asambleja e Ortakut të Vetëm që vendos rast pas rasti me vendim kohëzgjatjen e periudhës së emëritimit.	
11.5	Asambleja e Ortakut të Vetëm, nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, mund të lejojë ortakun dhe administratorët e shoqërisë të mbajnë një pozicion drejtues, apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimitari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqerinë e parë. Gjithashtu, këta persona me këtë autorizim të posaçëm, mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimitari në këtë sektor.	
<b>Neni 12</b>	<b>Kompetencat e Administratorit</b>	
12.1	Shoqëria administrohet nga një administrator, deri sa Asambleja e Ortakut të Vetëm të vendosë ndryshe me vendim.	
12.2	Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.	
12.3	Administratori përfaqëson shoqerinë përpara të gjithë personave fiziikë dhe juridikë, publikë dhe/ose privatë, vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.	
12.4	Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë në të gjitha rr Ethanat, me përashtim të kompetencave që ligji ia jep organit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë.	
12.5	Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëni me të tretët, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.	
12.6	Administratori ka gjithashtu të drejtëtë nënshkruajë kontrata për dhënie me qira, në emër e përllogari të shoqërisë (pas vendimit miratues të Asamblesë së Ortakut të vetëm), të nënshkruajë e të hartojë çdo dokument, e të kryejë në emër të shoqërisë çdo veprim përballë bankave shqiptare, apo të huaja në lidhje me çeljen, apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e shoqërisë, si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumash në këto llogari.	
12.7	Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se, të tretët e dinin që akti i administratorit e kalon objektin e shoqërisë, apo kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjafsheshme.	
12.8	Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.	
12.9	Administratorit, ose ortakëve që nuk janë persona juridik, nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të jalin pëlgimin në emër të saj, për paradhënie, si dhe të bëhen dorëzanës, apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.	
12.10	Përveç kompetencave të mësipërme, Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të: <ol style="list-style-type: none"> <li>kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e ortakut të vetëm;</li> <li>përfaqësojë shoqerinë tregtare;</li> <li>kujdeset përmbylljen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;</li> <li>përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së ortakut të vetëm për miratim;</li> <li>krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;</li> <li>kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;</li> <li>raportojë përpara asamblesë së ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë</li> </ol>	



	tregtare; ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj, në statut dhe në vendimet e asamblesë së ortakut të vetëm.
12.11	Administratori mund të autorizojë apo emërojë përfaqësues të posaçëm për kryerjen e ndonjë veprimi/akti të veçantë apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh/aktesh.
<b>Neni 13</b>	<b>Përgjegjësítë e Administratorit</b>
13.1	Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje statuti, të vendimeve të asamblesë apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
13.2	Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut të Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.
13.3	Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, asambleja e ortakut të vetëm ka të drejtë të ngrëjë padi penale kundrejt administratorit.
13.4	Asambleja e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndjekë në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë përfshirë edhe dëmin financiar, nëse është e nevojshme.
13.5	Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.
<b>KREU IV</b>	<b>VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE</b>
<b>Neni 14</b>	<b>Viti financiar</b>
14.1	Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Përashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar në QKB dhe mbyllet më 31 dhjetor.
14.2	Bilancet vjetore, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse është emëruar, miratohen nga Asambleja e Ortakut të Vetëm sipas ligjit.
14.3	Në vijim të mbylljes së vitit financiar, miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar të mbyllur, duhet të bëhet brenda datës 30 Qershor të vitit vijues.
<b>Neni 15</b>	<b>Fitimet</b>
15.1	Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% të destinuara për rezervën ligjore deri në 10% të kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos të vëré mënjanë, i shpërndahen ortakut.
15.2	Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shëpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.
<b>Neni 16</b>	<b>Ekspertët</b>
16.1	Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakut të Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave kontabël të shoqërisë, mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.
16.2	Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga asambleja e ortakut të vetëm.
16.3	Në përfundim të kontrollit/ve, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'i paraqesë e dorëzojë në kohë sipas kérkesës dhe përcaktimëve ligjore, për shqyrtim dhe miratim nga organi i shoqërisë mbi bazën e të drejtës vendimmarrëse që gëzon ky i fundit.
16.4	Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
<b>KREU V</b>	<b>TRANSFORMIMI I SHOQËRISË</b>
<b>Neni 19</b>	<b>Prishja dhe likuidimi</b>
19.1.	Shpërndarja ose prishja e shoqërisë, mund të bëhet në çdo kohë: a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar; b) me vendim të asamblesë së ortakut; c) me procedurat e falimentimit (sipas ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin"); ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare sipas afateve ligjore; d) në raste të tjera të parashikuara me ligj; dh) me vendim të gjykatës.
19.2	Në këtë rast Asambleja e Ortakut të Vetëm merr vendimin me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej



	tij: emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
19.3	Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e ortakut. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakut për të vendosur emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.
<b>Neni 20</b>	<b>Riorganizimi i shoqërisë (bashkimi e ndarja)</b>
20.1	Shoqëria mund të ndahet apo bashkohet sipas vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin përkatës për shoqëritë tregtare.
<b>KREU VI</b>	<b>DISPOZITA TË FUNDIT</b>
<b>Neni 21</b>	<b>Baza ligjore</b>
21.1	Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
21.2	Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Pëtregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar); ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" (i ndryshuar); ligjit nr. 131/2015, datë 26.11.2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"; ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin"; përcaktimet e kuadrit ligjor fiskal/tatimor, si dhe çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.
<b>Neni 22</b>	<b>Mosmarrëveshjet</b>
22.1	Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin, apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se ato nuk zgjidhen me mirëkuptim apo nëpërmjet ndërmjetësimit, për shqyrtimin e tyre do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë apo gjykatat e posaçme rast pas rasti sipas ligjit.
<b>Neni 23</b>	<b>Dispozita përfundimtare</b>
23.1	Ky Akt Themelimi dhe Statut u redaktua në 4 (katër) kopje me përbajtje e vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku Themelues i shoqërisë tregtare "BEDOUIN" sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin e firmën e tij originale (ndërsa vetëm nënshkrimin në çdo fletë).

Nënshkruar nga:

Z. Flladi Agolli

Ortak i vetëm

